



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 504/5 Prot.

Tiranë, më 11/4/2014

REKOMANDIM

Nr. 27, datë 11/04/2014

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "*Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "*Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit "*Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë*" (UMSH), Tiranë.

KONSTATOVA

Në zbatim të Urdhrit nr.45 datë 12.03.2014 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është ushtruar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit "*Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë*" (UMSH) Tiranë, me objekt:

- *Zbatimi nga ana e kontrolluesit "Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë" (UMSH), i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij në përfaqësimin e interesave të përbashkëta të profesioneve mjekësore dhe marrëdhëniet midis tyre në funksion të publikut.*

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi procesverbalin e kontrollit administrativ dhe provat e administruara vëren se:

Kontrolli administrativ ka filluar kryesisht nga zyra e Komisionerit dhe kontrolluesi është njoftuar paraprakisht për kryerjen e kontrollit. "*Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë*" në kuptim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar është kontrollues publik, i pavarur, i cili përfaqëson interesat e përbashkëta të anëtarëve të tij dhe rregullon marrëdhëniet midis tyre në funksion të publikut. Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë krijon dhe administron regjistrin themeltar Rajonal dhe Kombëtar të anëtarëve (mjekëve/stomatologëve) të Urdhrit.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë kontrolluesi përpunon të dhëna personale në procesin e krijimit të dosjeve për secilin anëtar (*mjek/stomatolog*) si: emër, mbiemër, gjinia, atësia, datëlindja, shtetësia, grada shkencore, kodi i mjekut, adresa e banimit, e-mail, tel, adresa profesionale, specialiteti, titulli i diplomimit, nr. i licencës, vlerësimi, masa/ndëshkime, data e regjistrimit, kontrolluesi mbledh edhe të dhëna personale për aplikantët që japin provimin e shtetit (*për mjekët e përgjithshëm dhe mjekët stomatologë*).

1. Kontrolluesi nuk kryen informimin e subjekteve të të dhënave personale, mbi mënyrën e mbledhjes, përpunimit, përhapjes, ruajtjes dhe masave të sigurisë që ai ka marrë për të dhënat personale të tyre:

Për subjektet që plotësojnë formularët e: “Regjistrimit”, “Vetëdeklarimit” dhe “Aplikimit”, për mënyrën e përpunimit, mbledhjen, ruajtjen, shkatërrimin, për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave personale,

Në faqen e tij në internet www.urdhrimjেকে.org.al, në të cilën nuk ka publikuar “politikat e privatësisë” (paketë rregullash), me qëllim informimin e subjekteve që vizitojnë këtë faqe mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Në këtë rast kontrolluesi ka shkelur nenin 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se informimi në kohën e duhur dhe sa më i saktë i subjekteve të të dhënave personale nga kontrolluesit është një detyrim shumë i rëndësishëm në drejtim të respektimit të privatësisë dhe përpunimit në respekt të ligjit i të dhënave personale. Informacioni duhet të jepet i saktë dhe sa më shpejtë që të jetë e mundur. Kur të dhënat mblidhen nga aplikantët/kandidatët e interesuar, informacioni mund të jepet në kohën e grumbullimit të të dhënave. Gjithashtu mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale përmes përdorimit të faqes tuaj të internetit duhet të kryhen sipas parimit të respektimit dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtës së ruajtjes së jetës private.

2. Kontrolluesi nuk trajton në mënyrë konfidenciale dhe të sigurtë informacionin si dhe të dhënat personale që mblidhen për anëtarët e tij, lidhur me masat/ndëshkime të cilat janë dhënë ndaj tyre. Këto informacione janë shumë të ndjeshme për subjektet e të dhënave (mjekëve/stomatologëve) të Urdhrit, prandaj është e domosdoshme që ato të mos trajtohen njësoj si të dhënat dhe informacionet tjera që mblidhen dhe përpunohen nga ana e kontrolluesit.

Në këtë rast kontrolluesi ka shkelur nenin 27 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se, këto të dhëna dhe të gjitha dokumentet që lidhen me zbatimin e masat/ndëshkime të cilat janë dhënë ndaj anëtarëve të tij, duhet të mbahen në regjistër dhe dosje të veçanta, ambiente të sigurt dhe për aq kohë për të cilën ato i shërbejnë qëllimit për të cilin janë mbledhur. Aksesit në regjistër dhe këto dosje duhet të jetë i kufizuar, duhet të zbatohet me përpikmëri procedura të cilat duhet të parashikohen në rregullore të hartuara nga kontrolluesi. Kontrolluesi duhet të përcaktojë subjektet drejt të cilave ka përhapje të të dhënave personale si dhe kohën e ruajtjes së dokumenteve që mblidhen dhe përpunohen gjatë procedurave të cilat kanë lidhje me masat/ndëshkime të cilat janë dhënë ndaj anëtarëve të tij. Rregulla të tilla janë të domosdoshme për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave (mjekëve/stomatologëve) të Urdhrit, gjatë përpunimit të të dhënave personale që kryeni ju si kontrollues.

3. Kontrolluesi nuk ka një rregullore të shkruar për mbledhjen, mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen si dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, në zbatim të neneve 27, 28 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se hartimi i rregulloreve është një pjesë e rëndësishme e masave të sigurisë që në tërësi zbaton kontrolluesi, prandaj është shumë e rëndësishme që ju si kontrollues të hartoni rregullore të veçantë për të përcaktuar rregulla për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. Në rregullore duhet të përcaktohen nivelet e përdoruesve, të drejtat e tyre, aksesit etj, si dhe rregulla lidhur me konfidencialitetin e të dhënave personale. Përmirësimi dhe plotësimi i rregullave është një siguri më shumë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave, gjatë përpunimit të të dhënave personale që kryeni ju si kontrollues.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative :

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar,

- Për subjektet që plotësojnë formularët e: "*Regjistrimit*", "*Vetëdeklarimit*" dhe "*Aplikimit*", të bëhet informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi mënyrën e mbledhjes, përpunimit, ruajtjes, të drejtën për akses, të drejtën për korrigjim, përhapjen e të dhënave personale dhe sigurinë e tyre .
- Në faqen tuaj në internet www.urdhrimjekeve.org.al, të publikohen në një rubrikë të veçantë "*politikat e privatësisë*" (*paketë rregullash*), me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale, si dhe të përfshihen kushtet e kriteret që reflektojnë parimet e përpunimit të ligjshëm dhe të drejtë të të dhënave personale. Disa nga këto parime do t'i gjeni në Opinionin "*Mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Faqen e Internetit të Kontrolluesve Publik dhe Privat*" publikuar në faqen zyrtare të KMDP-së www.kmdp.al.

2. Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar,

- Të gjitha dokumentet që lidhen me informacionin si dhe të dhënat personale që mbledhen për (*mjekët/stomatologët*) anëtarë të Urdhrit, lidhur me masat/ndëshkime të cilat janë dhënë ndaj tyre, të mbahen në regjistër dhe dosje të veçanta. Të kenë akses vetëm personat përgjegjës të cilët në çdo rast verifikimi të mundshëm të veprojnë plotësisht në përputhje me rregulloret e brendshme të kontrolluesit.

3. Në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, të hartohet rregullore e brendshme lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale. Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare të Komisionit www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë.

4. Kryerja e këtyre detyrimeve të rëndësishme të realizohet brenda një afati kohor prej 45 (*dyzet e pesë*) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni të këtij Rekomandimi.

5. Për plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

6. Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar, sipas të cilit... *"Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave"*.

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

